

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/06/2026

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – PUNË  
(PROCEDURË E HAPUR)  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM.**

I mbajtur sot në datë 09.06.2026 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës i emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit me Nr. 579/1 Prot datë 09.06.2026 për procedurën e prokurimit e Hapur-Punë me objekt: **“Ndërtimi i Kolektorëve për Fiderat 20kV, N.Stacioni Traktora + daljet e para të fiderave 20 kV”**.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Kabllo të tensionit të mesëm -31321220 -0. Punime ndërtimi 45210000-2.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 71,982,385.81 (Shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë lekë e tetëdhjetë e një qindarka) Lekë pa TVSH.

**Argumentimi:** Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është bërë referuar preventivit të hartuar nga specialistë të fushës, mbështetur në VKM nr. 216, datë 13.04.2023.

Studim tregu për kabëll 20kV 1x630 mm<sup>2</sup> me përcjellës bakri për shkak të nryshimit të shpeshtë në bursë të këtij metali.

Çmime referuar sistemit SAP të OSHEE SHA, për materialet e tjera të këtij projekti.

Zërat sipas cmimeve të e-Albania për punimet civile.

**Procedura e Prokurimit e zgjedhur në mbështetje Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, neni 42 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” ( i ndryshuar ), Kreu VI, neni 47, është “Procedurë e Hapur”.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
  - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga ana e tyre gjatë tre viteve të fundit financiare (2023-2024-2025). Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e fondit limit të procedurës së prokurimit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, Dega e Tatim Taksave.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin em ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*”

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe këstin përkatës për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar në QKB. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht **35,991,192.90 lek (pa TVSH)** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht **143,964,771.62 lek (pa TVSH)**.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh,

*kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (2.3.1.a – 2.3.1.b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

*Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.a – 1.b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e perqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

- Konkretisht, për kontrata të realizuara me **ent publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojës në DST për realizimin e punimeve*
  - b) *Kontrate Sipërmarrje*
  - c) *Situacionin përfundimtar*
  - d) *Akt kolaudimi objekti*
  - e) *Fature tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*
  
- Konkretisht, për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojës në DST për realizimin e punimeve*
  - b) *Kontrate Sipërmarrje*
  - c) *Situacionin përfundimtar*
  - d) *Akt kolaudimi objekti*
  - e) *Fature tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

---

### **2.3.2 Liçenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NP 1- A Punime gjurmimi në tokë;
- NP-2 A Ndertime civile industriale.
- NP-3 A Rikonstrukcion dhe mirebajtje godinash civile industriale,veshje fasadash.
- NP-11- B Ndërtime për N/Stacionet,kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve
- NS-4 A Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri...etj
- Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, Liçensat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.
- Kur Operatori Ekonomik është i huaj ai duhet të paraqesë liçencën e ekuivalentuar me kategoritë e kërkuara.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në liçencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

### Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Konkretisht:

Kategoritë e licencave janë përcaktuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohet të realizohen në funksion të përmbushjes së qëllimit të kontratës, ndërsa klasifikimi i tyre, sipas niveleve (gërmave) përkatëse është është përcaktuar në klasifikimin bazë (A) pasi volumet e punës që do të realizohen janë vetëm sasi / punime të planifikuara.

- **N.P - 1 A “Punime gërmimi në tokë”**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1 A** “Punime gërmimi në tokë” konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për germime per kanalet e rinje te kablllove te fuqise dhe fiderave 20/6kV te shperndarjes me punimet si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

<b>Punime germimi</b>		
Germim dheu me krah per kanale kablli	m <sup>3</sup>	374.20
Germim dheu me krah per pusete kablli	m <sup>3</sup>	14.60
Germim dheu me krah per kanal kablli	m <sup>3</sup>	50.40
Germim dheu me krah per kanal fiderin e ri	m <sup>3</sup>	144.00
Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krah, kategoria III	m <sup>3</sup>	21.60

• **N.P. - 2 A Ndërtime civile dhe industriale;**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 2 A** Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për betonimi i kanaleve te kablllove, etj. konkretisht për punimet si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

<b>Ndertime civile dhe industriale</b>		
Shtrese betoni C12/15 t=15 cm	m <sup>3</sup>	0.83

Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, (betonim pusete)	m <sup>3</sup>	5.30
Suvatim muri (riparime)	m <sup>2</sup>	50.00
Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 4cm, me krah	m <sup>2</sup>	24.00

- **N.P. - 3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 3 A** “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash” konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve ne fasada ekzistuese dhe te reja, për objektin ndertese ekzistuese dhe e re te N.Stacionit, konkretisht për punimet si vijon:

- **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

<b>Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale</b>		
Lyerje brenda+ jashte ( Boje hidroplastike cilesi e larte)	m <sup>2</sup>	2430.00
Suvatim muri (riparime)	m <sup>2</sup>	50.00

- **N.P. - 11 E “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 11 E** “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike” konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme elektrike si ne pajisjet e tensionit te larte, te mesem TU, ne N.Stacion dhe në ndërtesat e tij si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

<b>Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike</b>		
F.V. ne tub dhe konstruksione metalike kabell Cu, XLPE, 20kV (1x630/35 Cu) mm <sup>2</sup> per lidhjen e urave te transformatoreve te fuqise	ml	1500.00
F.V. Terminale njefazore 20kV, 1x630mm <sup>2</sup> , per transformaret e fuqise te jashtme	cope	27
F.V. Terminale njefazore 20kV, 1x630mm <sup>2</sup> , per transformaret e fuqise te brendshme	cope	27
F.V. ne toke kabell Al, XLPE, 20kV (1x240/25 Cu) mm <sup>2</sup> per fiderat 6/20kV	ml	9000.00
F.V. Terminal 20kV me kapikordë AL-CU për seksion (70÷240mm <sup>2</sup> ), unipolare për ambient të brendshëm	cope	90
F.V. ne tub dhe konstruksione metalike kabell Al, XLPE, 20kV (1x70/16 Cu) mm <sup>2</sup> per lidhjen e urave te transformatoreve te N.V	ml	400.00
F.V. Terminale 1 fazore, 20kV te brendshme (70-240 mm <sup>2</sup> ) per urat e transformatorit te N.V.	cope	6
F.V. Terminale 1 fazore, 20kV te jashtme (70-240 mm <sup>2</sup> ) per urat e transformatorit te N.V.	cope	6
F.V Mufte unipolare TM 24 kV për kabell të thatë AL XLPE , 1x(95÷240)mm <sup>2</sup>	cope	90
Kenotrimi i kabllave dhe kokave te kabllit	cope	33
F.V .Shirit paralajmerues PVC 150x0.5 mm	ml	500.00
Transport materiale elektrike me kamion me vinc 5 - 10 ton deri 20 km	ton	71.00

Demontimi i fiderave ekzistues 6 dhe 20kV	ml	7500.00
---	----	---------

- **N.S – 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 1 A** “Punime për prishjen e ndërtimeve”, konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore që paraprihen nga punimet e prishjes, ne kanalet ekzistues te kabllave te fuqise dhe ato te fiderave, si dhe ne ndertesasn ekzistuese konkretisht për punimet si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

<b>Punime Prishje</b>		
Prishje suvaje	m <sup>2</sup>	50.00
Prerje asfalti me disk, ne te dy anet.	ml	12.00
Prishje struktura beton/arme ( muret e kanaleve te kabllave)	m <sup>3</sup>	86.54
Prishje shtresa betoni ( brenda )	m <sup>3</sup>	12.10
Prishje themel betoni per kalim tubash	m <sup>3</sup>	0.40
Prishje themel muri rrethues	m <sup>3</sup>	2.20

- **N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 4 A** “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese” konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme

të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për grup punimet si vijon:

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

<b>Punime rifiniture te muratures, dyer dhe dritare etj</b>		
F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m <sup>2</sup>	14.300
Heqje dyer ekzistuese	m <sup>2</sup>	7.28
F.V Dyer d/alumini tek xh.	m <sup>2</sup>	3.38
F.V Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m <sup>2</sup>	3.90

a) **2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, të cilët duhet figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- ✓ Kontratë pune,
- ✓ Diplomën Universitare,
- ✓ Libreze pune,
- ✓ CV
- ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dy punësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

b) Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik dhe punonjes si më poshtë :

- Elektriciste 9 (nëntë)
- Punetore ndihmes 10 (dhjetë)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
3				
4				
5				

➤ Për **teknikët:**

- ✓ Kontratën individuale të punës
- ✓ Diplomën e shkollës së mesme profesionale përkatëse
- ✓ Libreze pune.
- ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

➤ Për **punonjësit ndihmes:**

- ✓ Kontratën individuale të punës;
- ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

### Argumentim 2.3.3 – a & b.

Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

### Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve.

Numri i inxhinierëve, teknikeve dhe punonjesve sipas profesioneve perkatese, eshte kerkuar duke pare procesin e punes, qe eshte shume i rendesishem dhe specifik, duke qene qe N.Stacioni do te jene ne pune dhe me tension, dhe punimet do te kryhen me shume kujdes sipas kushteve teknike te sigurimit teknik duke i respektuar ato ne maksimum, dhe po aq e rendesishme te mos ndikojne ne kufizimin e konsumatorëve qe ky N.Stacion furnizon.

Numri i tyre ne punimet e r ndertimit te kanaleve te rinj te kablllove te fuqise dhe fiderave te rrjetit TM shperndares eshte bazuar ne zerat dhe volumet e parashikuar ne punimet e preventivit, per arsyet e meposhtme:

- Punimet civile duhet te kryhen sa me shpejte, dhe me kujdesin maksimal duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik sepse jane punime brenda N.Stacionit dhe me pajisje ne tension, dhe nen rrezikun e jetes, si dhe kufizime minimale te nevojshme te energjise elektrike per konsumatorët e ketij N.Stacioni.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në montimin, instalimin, e te gjitha fiderave 20/6kV ne pune.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve civile objekt i kesaj kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në preventivin e ketij rikonstruksioni e te gjithë kanaleve te kablllove te fuqise dhe fiderave TM, si dhe punimet e ketyre kanaleve brenda ne ndertesën e N.Stacionit.
- **Elektriçistet** jane te nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të ketij objekti.
- **Punonjesit ndihmes** jane te nevojshem dhe ne funksion procesit te punes dhe zerave ne preventivin e ketij objekti.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

a) Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- ✓ Kontratën e punës,
- ✓ Diplomën/certifikatën përkatëse.
- ✓ Listpagesat E-Sig të shoqërisë.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

#### **Argumentim 2.3.4 . -a**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

b) Operatorët ekonomikë duhet që nga punonjësit e kërkuar më sipër, minimalisht punonjësit e kualifikuar si:

- Ing Elektrik 1 (një)
- Ing Ndertimi 1 (një)
- Elektricistë 9 (nëntë)

duhet të jenë të pajisur me OMVK në përputhje me kërkesat ose standardet ekuivalente sipas Rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike.

Për këtë operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 (a/b), duhet të paraqesin edhe **dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin OMVK**.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

#### **Argumentim 2.3.4 - b.**

Kërkesat e pikës 2.3.4, të kritereve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve.**

- Numri i punonjesve të kualifikuar me lart është i nevojshëm gjatë gjithë periudhës së kryerjes së punimeve, për shkak të volumit të punimeve, rëndësise dhe sigurisë që kanë këto punime dhe vendosjen e plote në punë të N.Stacionit me pajisjet e reja, duke minimizuar kohën e ndërprerjeve të energjisë në rast nevojë. Pra janë shumë procese pune në të njëjtën kohë, që kërkojnë grup pune me punonjes të kualifikuar për realizimin e tyre me sukses dhe kohën e duhur.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në montimin, instalimin, konfigurimin dhe venien në punë të pajisjeve të tensionit të lartë, tensionit të mesëm, panele mbrojtjeje, kontrolli, rrjeti shpërndaresh i furnizimit me rryme AC/DC etj.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve civile objekt i kësaj kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në preventivin e këtij rikonstruksioni dhe ndërtimi ndertese të re, bazamentet e pajisjeve etj.

- **Elektriciçistët** janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.

**2.3.5** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Automakinist te mjeteve te renda / manovrator 2 (dy)

*(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).*

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- ✓ Kontratat e punës të vlefshme;
- ✓ Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.
- ✓ Liste pagesat. E-Sig

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

### **Argumentimi**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Në lidhje me punonjësit manovrator te kerkuar, theksojmë se keta punonjes duhet te disponohen dhe te kene eksperience te nevojshme per te bere te mundur levizjet e konteniereve mobile

provizore qe do vendosen ne N.Stacion per spostimin e te gjithë fiderave qe jane ne pune, per te realizuar kryerjen e punimeve me kushte teknike te sigurta dhe rakordimin e veprimeve gjate ketyre spostimeve.

**2.3.6** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt me emërtesën e artikullit në të cilën duhet të deklarohen të dhënat e kërkuara, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania Prodhuese e artikullit të ofruar	Referenca për specifikimet teknike sipas katalogëve të artikullit të ofruar
1.	<b>Kabell Cu, XLPE, 20kV (1x630/35 Cu) mm<sup>2</sup>.</b> (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
2.	<b>Terminale njefazore 20kV, 1x630mm<sup>2</sup>, per ambjent te jashtem.</b> (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
3.	<b>Terminale njefazore 20kV, 1x630mm<sup>2</sup>, per ambjent te brendshem.</b> (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		
4.	<b>Mufte njefazore 20kV, 1x240mm<sup>2</sup>, per ambjent te jashtem.</b> (sipas specifikimeve teknike ne Relacion)		

### Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të kësaj skede Autoriteti Kontraktor orienton ofertuesit të evidentojnë produktet e ofruara dhe e lidhur me kërkesat e tjera për kualifikim në vijim, AK garantohet për cilësinë e produkteve të ofruara dhe faktin se oferta teknike është bazuar në produkte reale që plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara.

**2.3.7** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin Autorizim të prodhuesit/Distributorit të autorizuar. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, për listën e mallrave të mëposhtëm:

1. Kabell 20kV percjelles bakri, izolacion XLPE, 1x630/35mm<sup>2</sup>.

2. Terminale 20kV Terminale njefazore 20kV, 1x630mm<sup>2</sup>, per ambjent te jashtem.
3. Terminale 20kV Terminale njefazore 20kV, 1x630mm<sup>2</sup>, per ambjent te brendshem.
4. Muftë njefazore 20kV, 1x240mm<sup>2</sup>.

### **Argumentim**

*Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet SSH/IEC/DIN/EN.*

*Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

**2.3.8** Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi ose ekuivalentet e tyre të kryera me pare, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara.

### **Argumentim**

*Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Duke marrë parasysh që e gjithë lista e kërkuar përbehet nga pajisje të vecanta që perdoren në N/stacione elektrike, kërkohet nga prodhuesi që të deshmohet se është prodhues i certifikuar nga institucione ndërkombetare sipas standarteve IEC/EN/SSH dhe pajisjet kanë kryer testimet e kërkuara, testet tip ose rutine nga prodhuesit/prodhuesve ose distributorët e autorizuar, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

**2.3.9** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ekuivalentet e tyre për listën e materialeve të mësipërme që do të ofrohen si mesiper, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike baze.

***Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.***

## Argumentim

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.10** Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

<i>Nr</i>	<i>Pershkrimi i mjeteve</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1.	Kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës minimum 5 (pesë) ton dhe maksimumi 10 (dhjetë) ton.	1 copë	Pronësi ose me qera
2.	Kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 ton (tre ton e gjysem).	1 copë	Pronësi ose me qera
3.	Betoniere 500 litra	2 copë	Pronësi ose me qera
4.	Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera
5.	Eskavator me goma 0.25 m <sup>3</sup>	2 copë	Pronësi ose me qera
6.	Moto Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
7.	Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove	2 copë	Pronësi ose me qera
8.	Kenetron për kablo	1 copë	Pronësi ose me qera
9.	Prese hidraulike 630mm <sup>2</sup> per kapikorda	1 copë	Pronësi ose me qera

**Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :**

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësi vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

### **Argumentimi**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i u referuar punimeve sipas standardeve, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

### **Mjetet dhe pajisjet si më sipër kërkohen referuar zërave të preventivit të punimeve.**

Konkretisht mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë si më poshtë :

Pajisjet e mesiperme jane kerkuar si domosdoshmeri per realizmin e punimeve ne kolektoret e kablllove dhe fiderva TM te N.Stacionit Traktora Tirane sipas zerave te punimeve qe do te kryehen, dhe materiale qe do te transportohen ne kete objekt si me poshte:

- **Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtës 5–10 ton**  
Përdoret për transportin e dherave, inerteve, zhavorrit, rërës, betonit dhe materialeve të tjera ndërtimore, si dhe për largimin e materialeve të gërmuara.
- **Kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 ton**  
Përdoret për transportin e veglave, materialeve të lehta, pajisjeve dhe personelit në kantier.
- **Betoniere 500 litra**  
Përdoret për përgatitjen e betonit në vendin e punës për themele, bazamente, kanale kabllosh dhe punime të tjera civile.
- **Vibrator për beton**  
Përdoret për ngjeshjen e betonit të freskët, eliminimin e fluskave të ajrit dhe rritjen e rezistencës së betonit.
- **Eskavator me goma 0.25 m<sup>3</sup>**  
Përdoret për gërmimin e kanaleve për kablo, themele, sistemime terreni dhe punime të ndryshme të tokës.
- **Moto gjenerator**  
Siguron furnizim me energji elektrike për pajisjet dhe veglat e punës në zona ku mungon rrjeti elektrik ose si burim rezervë.
- **Këmbaleca për mbajtjen e bobinave të kablllove**  
Përdoren për vendosjen dhe mbajtjen e bobinave gjatë shtrirjes së kablllove, duke lehtësuar çmbështjelljen e tyre pa dëmtime.
- **Kenetron për kablo (Cable Roller)**  
Përdoret gjatë tërheqjes dhe shtrirjes së kablllove për të zvogëluar fërkimin dhe për të shmangur dëmtimin e izolimit të kabllit.
- **Presë hidraulike 630 mm<sup>2</sup> për kapikorda**  
Përdoret për shtrëngimin (krimpimin) e kapikordave dhe terminaleve në kablo me seksion deri në 630 mm<sup>2</sup>, duke siguruar lidhje elektrike të qëndrueshme dhe të besueshme.

Për mjetet e përmendura më sipër, drejtuesit e tyre të kenë leje drejtimi përkatëse.

**2.3.10** Operatorët ekonomik ofertues që do të realizojnë këtë kontratë, duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikatat përkatëse të vlefshme ose ekuivalentet e tyre, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, SSH EN ISO si më poshtë:

- ✓ Certifikatë **SSH EN ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- ✓ Certifikatë **SSH EN ISO 45001:2023** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- ✓ Certifikatë **SSH EN ISO 14001:2018** ose ekuivalente mbi “Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

### **Argumentimi**

Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë, standardet e menaxhimit të energjisë dhe sigurisë së informacionit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë të energjisë dhe sigurisë së informacionit.

Për vet natyrën e veçantë, rëndësinë, vendndodhjen dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë të energjisë dhe sigurisë së informacionit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Certifikatë **SSH EN ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve

publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: 2015 me qëllim për të planifikuar, kontrolluar dhe përmirësuar cilësinë e pajisjeve, punimeve shërbimeve ne perputhje me kerkesat teknike te projektit.

Certifikatë **SSH EN ISO 45001:2023** është standard ndërkombëtar, dhe kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik zbaton një sistem të certifikuar të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, me qëllim identifikimin dhe kontrollin e rreziqeve, mbrojtjen e personelit gjatë zbatimit të punimeve dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore dhe teknike të sigurisë në punë.”

AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Certifikatë **SSH EN ISO 14001-2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

### **Koha e kryerjes se punimeve 7 muaj nga lirimi i sheshit.**

**Sqarim:** Cdo kriter i parashikuar ne nenin 26, piak 2 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) dhe ne shtojcen nr. 8 te Dokumentave Standarte te Tenderit, përmbushet nga Operoret Ekonomik nepermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Ne baze te nenit 26 ,pika 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ” (i ndryshuar) , “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.”.

Ne rast bashkimi te opratoreve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. ( *neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* )

Dokumentet ne gjuhe te huaj duhet te jene te perkthyer ne shqipe dhe te noterizuara.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t’i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO ose cdo ekuivalent tjetër.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Reflektim:** “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

**Operatori Ekonomik** duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lene në dispozicion për realizimin e kontratës.

**Shënim:** Kudo që është përdorur fjala “importi” zëvendësohet “importi ose ekuivalent”

**Garancia e punimeve,** në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet operatorit ekonomik fitues 2 vite pas kolaudimit të punimeve.

**Dokumentat e leshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vertetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hages për Vullen Apostile, të datës 05.10.1961;**

**Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.**
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.**

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

**Njësia e Prokurimit bëri llogaritjen e afateve dhe vendosi që duke filluar nga data e hedhjes në sistem data e fundit e pranimit të ofertave dhe e zhvillimit të prokurimit të jetë data 25.06.2026 ora 11.00**

**Personi i autorizuar për të ngarkuar në sistem DST dhe gjithë dokumentat e tenderit do të jetë Z. Aleksandër Pjetri.**

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

**❖ Njësia e Prokurimit**

**Aleksandër Pjetri      Përgjegjës prokurimi**